



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.02

Prishtinë, më 11.10.2017, në ora:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Imet Rrahmani, Xhevahire Izaku, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Jasmina Zivkovic, Fisnik Ismaili dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e OSBE- së, KDI- së, RTK- së, Kosova-Indo dhe Radio-Kosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit, me këtë rend të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.10.2017;
3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2016;
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radio -Televizionit të Kosovës, për vitin 2016;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.10.2017;
Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 06.10.2017, u miratua pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Komisioni shqyrtoi draft-planin e punës dhe e plotësoi si vijon:

Muaji tetor

Kryetari i komisionit, propozoi që raporti vjetor i KPM-së dhe i RTK-së të shqyrtohen në mbledhjen e radhës, ndërsa për Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, meqë është shqyrtuar nga komisioni funksional i legjislaturës së pestë dhe është nxjerrë rekomandim për procedim në seancë, të rekomandohet për Kuvend për miratim. Komisioni edhe për raportin në fjalë vendosi të rishqyrtohet nga komisioni.

- Të ftohen në raportim, ministri i Ministrisë së Administratës Publike dhe ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal;
- Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën;
- Nisma legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës;
- Nisma legislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Muaji nëntor

- Projektligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në OJQ-të.

Muaji dhjetor

Kryetari i komisionit, propozoi që P/ligji për Qeverinë e Kosovës të mos inkorporohet si pjesë e planit të punës së komisionit, me arsyen që të kërkohet nga Qeveria që P/ligji në fjalë duhet të shqyrtohet bashkë me Ligjin për Kuvendin.

- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike;
- Projektligji për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
- Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2018 për ministritë dhe institucionet e pavarura që janë nën fushëveprimin e Komisionit;
- Analiza e realizimit të planit të punës për vitin 2017.

Përfundim: Komisioni vendosi që të mblidhen nënshkrimet e anëtarëve të komisionit për nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-046 për RTK-në dhe nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Raportet vjetore të institucionevetë pavarura të shqyrtohen në mbledhjen e radhës dhe të ftohen përfaqësuesit e institucioneve për të prezantuar raportet.

7. Të ndryshme

Shqipe Pantina, njoftoi komisionin për kërkesën që i kishte parashtruar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për një anëtare të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, e cila në të njëjtën kohë është zyrtare e Ministrisë së Arsimit. Lidhur me këtë kërkesë KPMSHCK ka nxjerrë Vendimin nr.103/2017, datë 20.07.2017, sipas së cilit vendim është konstatuar se anëtarja e Bordit ka shkelur Ligjin për shërbimin civil të Kosovës.

Lidhur me këtë znj. Shqipe Pantina ka kërkuar përkrahjen e komisionit që t'i rekomandohet Kuvendit shkarkimi i të njëjtës nga Bordi i RTK-së, për arsye se shkelja është e ndërlidhur edhe me ushtrimin e funksionit, si anëtare e Bordit të RTK-së, konform Ligjit për RTK-në.

Kryetari i komisionit, duke e përkrahur Vendimin e KPMSHCK, propozoi që znj. Shqipe Pantina çështjen ta ngritë në Kuvend, për mosrespektim të vendimeve të Këshillit nga Ministria e Arsimit.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani